



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KOMISIONERËT PUBLIKË

Nr. 545/5 prot.

Tiranë, më 25.10.2019

- Lënda:** Ankim i Komisionerit Publik kundër vendimit nr. 187, të datës 24.7.2019, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, për subjektin e rivlerësimit z. Elvin Gokaj
- Baza ligjore:** Neni 179/b, pika 5, i Kushtetutës, neni C, pika 2, neni F i aneksit të Kushtetutës, neni 63 i ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”
- Për kompetencë:** Kolegjit të Posaçëm të Apelit, pranë Gjykatës Kushtetuese
- Për dijeni:** Operacionit Ndërkombëtar të Monitorimit (ONM)
- Depozituar pranë:** Komisionit të Pavarur të Kualifikimit

Të nderuar zonja/zotërinj, gjyqtarë të Kolegjit të Posaçëm të Apelit, pranë Gjykatës Kushtetuese,

Në zbatim të nenit 55, pika 7, e ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në RSH”, pranë Institucionit të Komisionerëve Publikë, më datë 10.10.2019, është njoftuar vendimi nr.187, datë 24.7.2019, për subjektin e rivlerësimit z. Elvin Gokaj, prokuror/Drejtnes në Prokurorinë e Apelit, Shkodër.

Komisioneri Publik, në mbështetje të nenit C, pika 2, nenit F i aneksit të Kushtetutës dhe nenit 63, pika 1, e ligjit nr. 84/2016, ka të drejtë të ankimojë vendimin brenda afatit 15-ditor nga njoftimi.

Brenda afatit ligjor, unë, Komisioneri Publik Darjel Sina ushtroj ankim ndaj vendimit nr. 187, të datës 24.7.2019, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit.

I. Procesi i rivlerësimit dhe përfundimet e Komisionit të Pavarur të Kualifikimit

1. Subjekti i rivlerësimit, z. Elvin Gokaj, ushtron detyrën e prokurorit/Drejtnesit në Prokurorinë e Apelit, Shkodër. Referuar pikës 3, të nenit 179/b, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe nenit 4, të ligjit nr. 84/2016, i është nënshtruar procesit të rivlerësimit *ex officio*.

2. Për këtë qëllim, Komisioni i Pavarur i Kualifikimit (në vijim referuar si Komisioni) ka administruar raportet e vlerësimit të hartuara për këtë subjekt nga institucionet ndihmëse, si

Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave (në vijim referuar si ILDKPKI), raportin e vlerësimit të figurës nga Drejtoria e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar (në vijim referuar si DSIK) dhe raportin e vlerësimit profesional nga Grupi i Punës i Prokurorisë së Përgjithshme (në vijim referuar si GPPP), nga të cilat rezulton se:

2.1 **ILDKPKI**, bazuar në nenin 33, pika 5, e ligjit nr. 84/2016, me anë të “Aktit të përfundimit të kontrollit të plotë të deklaratës së pasurisë për subjektin Elvin Gokaj¹”, ka referuar për subjektin, se:

- i. ka burime financiare të ligjshme për të justifikuar pasuritë;
- ii. nuk ka kryer fshehje të pasurisë;
- iii. nuk ka kryer deklaram të rremë;
- iv. subjekti nuk gjendet në situatën e konfliktit të interesave.

2.2 **DSIK**, bazuar në nenin 39, pika 2, të ligjit nr. 84/2016, me anë të raportit mbi kontrollin e figurës për subjektin e rivlerësimit, në të cilin parashtrohet fakti se vlerësimi kryhet në mungesë të informacionit nga ana e SHISH-it², i ka referuar Komisionit: “Përshatshmërinë për vazhdimin e detyrës”.

2.3 **GPPP**, bazuar në nenin 43 pika 2, e ligjit nr. 84/2016, ka përcjellë pranë Komisionit raportin për aftësitë profesionale³, nga analiza e të cilit, së bashku me vlerësimin e denoncimeve nga publiku, Komisioni ka konstatuar mangësi në aftësitë e tij profesionale, të cilat mund të plotësohen nëpërmjet programit të trajnimit pranë Shkollës së Magjistraturës.

3. Përfundimet e Komisionit për secilin kriter kontrolli, në mënyrë të përmbledhur, janë si vijon:

3.1 **Për vlerësimin e pasurisë.** Komisioni, lidhur me vlerësimin e pasurisë, ka arritur në përfundimin se: “Në përfundim të hetimit administrativ, pasi shqyrtoi dokumentacionin e administruar nga hetimi, provat dhe shpjegimet e subjektit, si dhe e dëgjoi atë në seancë, Komisioni konstaton se subjekti ka qenë i saktë në deklaramin e tij, por ka pasur pamjaftueshmëri të mjeteve financiare në shumën 826.717 lekë, për pagesën e këstit të parë për pasurinë e ndodhur në Durrës. Duke arsyetuar mbi bazën e parimit të proporcionalitetit, duke vënë në balancë vlerën e kësaj pamjaftueshmërie, në raport me provat e tjera të administruara nga Komisioni, nëpërmjet hetimit të tij, Komisioni vlerëson se subjekti ka arritur të argumentojë burimin e ligjshëm të pasurive dhe të ardhurave të veta, si detyrimi kryesor kushtetues i tij. Mungesa e të ardhurave për pagesën e këstit të parë nuk mund të shërbejë si shkak për masë disiplinore, duke qenë se nuk përmbushen kriteret e parashikuara në pikën 1 dhe 3 të nenit 61 (f. 22-23 e vendimit). Në këto kushte, Komisioni ka vlerësuar se subjekti i rivlerësimit, z. Elvin Gokaj, ka arritur një nivel të besueshëm në vlerësimin e pasurisë, sipas parashikimit të nenit 59/1, germa “a”, të ligjit nr. 84/2016.

3.2 **Për kontrollin e figurës.** Referuar nenit DH të aneksit të Kushtetutës dhe nenit 39 të ligjit nr. 84/2016, Komisioni, në konsideratë të verifikimit dhe të konfirmimit nga institucionet përgjegjëse për përshtatshmëri në detyrë, pas kryerjes se hetimit të thelluar si dhe vlerësimit të

¹ Raporti me nr. *** prot., datë ***.1.2018, i ILDKPI-së, nuk rezulton të jetë shprehur lidhur me saktësinë ose jo të deklaramit të subjektit të rivlerësimit.

² Shkresë nr.*** prot., datë ***.11.2017, e DSIK-së (Deklasifikuar plotësisht me vendim të KDZH-së nr. *** , datë ***.2.2018.

³ Raporti me nr. *** prot., datë ***.1.2018.

provave dhe shpjegimeve të subjektit, ka vlerësuar se subjekti ka plotësuar saktë deklaratën e kontrollit të figurës, si dhe nuk ka kontakte të papërshtatshme me persona të përfshirë në krimin e organizuar në kuptim të pikës 15, të nenit 3, të ligjit nr. 84/2016, duke konkluduar se, në lidhje me vlerësimin e figurës, subjekti është i përshtatshëm për të vazhduar detyrën. Sjellim në vëmendje se Raporti i DSIK-së është hartuar pa përgjigjen e një prej institucioneve të verifikimit të figurës, atë të Shërbimit Informativ Shtetëror.

3.3 Për vlerësimin e aftësive profesionale. Referuar nenit E të aneksit të Kushtetutës, nenit 43/2 dhe 44 të ligjit nr. 84/2016 dhe kreut II të ligjit nr. 96/2016, “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në RSH”, të ndryshuar, Komisioni, pasi ka administruar raportin e përgatitur nga GPPP-ja, hetimin dhe vlerësimin e dokumenteve të depozituara nga vetë subjekti; dosjet e zgjedhura me short; të dhënat arkivore lidhur me ankesat, masat disiplinore dhe vlerësimet si dhe nga gjetjet gjatë shqyrtimit të denoncimeve të paraqitura pranë Komisionit, ka arritur në konkluzionin se: *“subjekti ka shfaqur njohuri, aftësi dhe gjykim të cekët në punën profesionale të tij, si dhe një mënyrë pune që nuk pajtohet me pozicionin e tij si drejtues i Prokurorisë, si më poshtë vijon:*

- *Në tetë raste, Komisioni ka konstatuar se subjekti i rivlerësimit ka treguar njohuri dhe aftësi të cekëta dhe gjykim të dobët për kryerjen e procedurave dhe veprimeve të nevojshme hetimore.*
- *Në dy raste, Komisioni ka konstatuar njohuri të cekëta të subjektit të rivlerësimit në lidhje me figurën e veprës penale.*
- *Në tri raste, Komisioni ka konstatuar se subjekti i rivlerësimit ka shfaqur njohuri të cekëta dhe gjykim të dobët për analizimin e masës së dënimit të kërkuar.*
- *Në tri raste, Komisioni ka konstatuar se subjekti ka shfaqur njohuri të cekëta dhe gjykim të dobët në lidhje me analizimin e provave të administruara.*
- *Në dy raste, Komisioni ka konstatuar se subjekti i rivlerësimit ka paraqitur njohuri të cekëta dhe gjykim të dobët në analizimin e provave dhe argumentimin e masës së sigurimit konform neneve 229-230 të K. Pr. Penale.*
- *Në një rast, Komisioni ka konstatuar se subjekti i rivlerësimit ka shfaqur njohuri të cekëta në lidhje me të drejtat e të pandehurit dhe mbrojtësit të tij.*
- *Në dhjetë raste, Komisioni ka konstatuar një mënyrë pune që nuk pajtohet me pozicionin e tij si drejtues i Prokurorisë. Pavarësisht pozicionit të tij si drejtues prokurorie dhe shpjegimeve të tij për përgjegjësi të prokurorit dhe jo drejtuesit, Komisioni konkludon se subjekti ka pasur detyrimin ligjor të thellohej në arsyetimin e vendimeve, të kontrollonte lidhjen logjike të argumenteve me kërkesat e prokurorëve përpara gjykatës, si detyrim ligjor i përcaktuar nga ligji procedural penal dhe aktet nënligjore të dala në zbatim të tij...*

4. Vendimi i Komisionit. Nisur nga përfundimet e mësipërme për secilin kriter kontrolli, në përfundim të procesit të rivlerësimit, shumica e trupit gjykues⁴ ka konkluduar se subjekti i rivlerësimit ka arritur një nivel të besueshëm të vlerësimit të pasurisë dhe të kontrollit të figurës, ndërsa në lidhje me aftësitë profesionale ka konstatuar mangësi në aftësitë e tij profesionale e, për këto arsye, bazuar në nenin 58, pika 1, germa “b”, dhe nenin 60, pika 1, të ligjit nr. 84/2016, me shumicë votash, ka vendosur:

⁴ Kryesuesja e çështjes ka dalë në pakicë dhe ndan mendim të kundërt për vlerësimin e kriterit të pasurisë, kontrollit të figurës dhe vlerësimin profesional.

1. *Pezullimin nga detyra të zotit Elvin Gokaj për një periudhë njëvjeçare dhe detyrimin për të ndjekur programin e trajnimit, sipas kurikulave të miratuara nga Shkolla e Magjistraturës.*
2. *Vendimi i arsyetuar, me shkrim, u njoftohet subjektit të rivlerësimit, Komisionerit Publik dhe vëzhguesve ndërkombëtarë, brenda 30 ditëve pas përfundimit të seancës dëgjimore, dhe publikohet në faqen zyrtare të internetit të Komisionit, në përputhje me pikën 7, të nenit 55, të ligjit nr. 84/2016.*
3. *Ky vendim ankimohet pranë Kolegjit të Posaçëm të Apelimit nga subjekti i rivlerësimit dhe/ose Komisioneri Publik 15 ditë nga data e njoftimit të vendimit. Ankimi depozitohet pranë Komisionit të Pavarur të Kualifikimit.*

II. Shkaqet e ankimit

5. Në zbatim të nenit 179/b të Kushtetutës, aneksit të Kushtetutës dhe ligjit nr. 84/2016, Komisioneri Publik është një nga tri institucionet që kryejnë procesin e rivlerësimit kalimtar (Vetting).
6. Bazuar në këto parashikime kushtetuese dhe ligjore, Komisionerit Publik, si përfaqësues i interesit publik në kryerjen e këtij procesi, i njihet e drejta e ankimit kundër vendimeve të Komisionit, pranë Kolegjit të Posaçëm të Apelimit (në vijim referuar si Kolegji).
7. Në krahasim me kompetencat kushtetuese dhe ligjore që u njihen Komisionit dhe Kolegjit nga neni Ç, i aneksit të Kushtetutës dhe nenet 48 - 52, të ligjit nr. 84/2016, Komisioneri Publik është i detyruar që kompetencën e tij për të ushtruar ankim ndaj vendimeve të Komisionit ta mbështesë vetëm në aktet dhe provat e administruara gjatë kryerjes së procesit të rivlerësimit nga ana e Komisionit.
8. Në të tilla rrethana ligjore, me qëllim garantimin e mbrojtjes së interesit publik gjatë procesit të rivlerësimit, Komisioneri Publik ka detyrimin që të ushtrojë kontroll mbi vendimet e dhëna nga Komisioni, në gjendjen që janë aktet, duke vlerësuar nëse vendimmarrja është në përputhje me kërkesat kushtetuese e ligjore, bazohet në një hetim administrativ të gjithanshëm e shterues dhe vlerësim të drejtë të provave.
9. Edhe në rastin konkret, Komisioneri Publik, mbështetur në kompetencën e tij kushtetuese dhe ligjore, nga shqyrtimi i vendimit nr. 187, datë 24.7.2019, dhe provave të administruara nga Komisioni, vlerëson se vendimi është i cenueshëm në tërësinë e tij dhe përmban shkaqe të mjaftueshme ligjore për t'u paraqitur për shqyrtim, nëpërmjet ankimit, juridiksionit kontrollues dhe rivlerësues të Kolegjit.
10. Nisur nga hetimi administrativ dhe vlerësimi që ka kryer Komisioni për të tria kriteret e rivlerësimit, Komisioneri Publik konstaton se, për sa i takon vlerësimit të pasurisë, bazuar në kërkesat e nenit D të aneksit të Kushtetutës dhe ligjit nr. 84/2016, përfundimet e Komisionit për këtë kriter kontrolli ndaj subjektit të rivlerësimit dhe personave të lidhur me të, nuk gjejnë mbështetje të plotë në aktet dhe provat e administruara.
11. Komisioneri Publik vëren se, megjithëse Komisionit i kanë rezultuar rrethana dhe fakte të provuara se subjekti, për kriterin e pasurisë: (i) nuk ka dhënë prova konkrete dhe shpjegime bindëse lidhur me shpenzimet e kryera për blerjen e pasurisë: apartament banimi në Durrës; (ii) ka kryer deklarime të pasakta dhe të pamjaftueshme ndër vite, si dhe (iii) rezulton me

mungesë të burimeve të ligjshme financiare, ka konkluduar se subjekti ka arritur një nivel të besueshëm të kontrollit të pasurisë.

12. Komisioni, duke u bazuar në interpretime dhe zbatim të gabuar të dispozitave të aneksit të Kushtetutës, ligjit të posaçëm dhe vlerësimit jo objektiv të fakteve, udhëhequr nga parimi i proporcionalitetit, zbatimi i të cilit (parimi i proporcionalitetit), në gjykimin e Komisionerit Publik, nuk është i përshtatshëm në rrethanat konkrete të provuara, ka konkluduar se subjekti ka arritur një nivel të besueshëm të vlerësimit të pasurisë.

13. Lidhur me kriterin e kontrollit të figurës, **DSIK**, me shkresën nr.*** prot., datë ***.11.2017⁵, bazuar në nenin 39, pika 2, të ligjit nr. 84/2016, me anë të raportit mbi kontrollin e figurës për subjektin e rivlerësimit, ka konstatuar *përshtatshmërinë për vazhdimin e detyrës të subjektit të rivlerësimit, z. Elvin Gokaj*, në mungesë të informacionit nga ana e SHISH-it.

14. Gjithashtu, lidhur me kriterin e aftësive profesionale, nga Komisioni janë konstatuar problematika të cilat, nëse do të merreshin në konsideratë në një vlerësim tërësor të procedurave, do të duhet të çonin në një vendim të ndryshëm nga sa ka konkluduar Komisioni.

15. Komisioneri Publik çmon se qëllimi për kryerjen e procesit të rivlerësimit, i parashikuar në pikën 1, të nenit 179/b, të Kushtetutës, realizohet përfundimisht nëpërmjet konfirmimit në detyrë apo shkarkimit nga detyra të subjektit të rivlerësimit, pa marrë në konsideratë këtu pezullimin nga detyra, shoqëruar me ndjekjen e programit trajnues, si një masë e përkohshme (1 vit), e cila në vijim do të përfundojë me vendimmarrje të organit rivlerësues për konfirmim në detyrë apo shkarkim, vetëm në varësi të rezultateve të testimit të aftësive të tij profesionale, pasi, për kriterin e vlerësimit të pasurisë dhe kontrollit të figurës, Komisioni ka çmuar se subjekti ka arritur një nivel të besueshëm.

16. Ashtu sikurse Kushtetuta e parashikon në nenin E të aneksit të saj, vendimi që urdhëron pezullimin nga detyra me detyrimin për trajnim, identifikon mangësitë e konstatuara në vlerësim të kriterit të aftësive profesionale, por në vlerësimin e Komisionerit Publik, në funksion të qëllimit të procesit të rivlerësimit, duhet që vendimi, në të njëjtën kohë, të argumentojë konkluzionin përfundimtar të Komisionit mbi vlerësimin e dy kritereve të tjera, në të cilat subjekti duhet patjetër të ketë arritur një nivel të besueshëm dhe kualifikues.

17. Në kuptim edhe të qëllimit të shpallur në nenin 179/b, pika 1, e Kushtetutës, e cila parashikon: “Sistemi i rivlerësimit ngrihet me qëllim që të garantohet funksionimi i shtetit të së drejtës, pavarësia e sistemit të drejtësisë, si edhe të rikthehet besimi i publikut tek institucionet e këtij sistemi”, Komisioneri Publik vlerëson se procesi i rivlerësimit kërkon që të zhvillohet në funksion të rikthimit të besimit të publikut te sistemi i drejtësisë, si edhe te garantimi i funksionimit të shtetit të së drejtës.

18. Komisioneri Publik çmon se, në vlerësimin tërësor të procedurave, për sa kohë subjekti gjendet në kushtet e parashikuara në nenin 61/3 të ligjit nr. 84/2016, në kuptim dhe të nenit 4, pika 2, dhe nenit 61/5 të ligjit nr. 84/2016, vendimi mund të ankimohet.

19. Nisur nga hetimi dhe vlerësimi i kryer nga Komisioni, pavarësisht vendimmarrjes mbi njërin nga kriteret e rivlerësimit, atë të vlerësimit të aftësive profesionale, bazuar në kërkesat e dispozitave të aneksit të Kushtetutës dhe ligjit të posaçëm nr. 84/2016, Komisioneri Publik

⁵ Deklasifikuar plotësisht me vendim të KDZH-së nr. ***, datë ***.2.2018.

konstaton se përfundimet e arritura nga Komisioni, mbi vlerësimin e kriterit të pasurisë, janë të gabuara dhe jo në pajtueshmëri me provat e administruara.

20. Në përfundim të sa më sipër, bazuar në nenin C, pika 2, nenin F, pikat 3 dhe 7, të aneksit të Kushtetutës, si dhe nenet 4 dhe 66, të ligjit nr. 84/2016, Komisioneri Publik ankimon vendimin nr. 187, datë 24.7.2019, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit.

II.A Vlerësimi i Komisionerit Publik

21. Për sa i takon rivlerësimin të kriterit të pasurisë, referuar nenit D të aneksit të Kushtetutës dhe neneve 30-33 të ligjit nr. 84/2016, Komisioneri Publik mban në konsideratë se, gjatë kryerjes së procedurave të rivlerësimin, objekti i hetimit dhe i vlerësimin të pasurisë ndaj subjekteve që i nënshtrohen këtij procesi, sipas nenit 179/b të Kushtetutës, materializohet në kontrollin e saktësisë dhe mjaftueshmërisë së deklarimeve të subjektit (“Vetting” dhe ato periodike), ku në çdo rast subjekti i rivlerësimin duhet të deklarojë tërësinë e pasurisë së tij dhe shpjegojë bindshëm ligjshmërinë e burimit të krijimit të saj, si dhe ekzistencën e të ardhurave të ligjshme, sipas përkufizimit kushtetues.

22. Rezulton se subjekti i rivlerësimin, z. Elvin Gokaj, është bërë subjekt deklarues për herë të parë në vitin 2003 dhe, në zbatim të ligjit nr. 9049, datë 10.4.2003, “Për deklarimin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publikë”, të ndryshuar, dhe ligjit nr. 9367, datë 7.4.2005, “Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike”, të ndryshuar, ka dorëzuar në ILDKPKI deklaratat e interesave private periodike për vitet 2003-2016 (në vijim DV-20...) dhe në datë 20.1.2017 ka dorëzuar në ILDKPKI deklaratën “Vetting”, sipas shtojcës nr. 2, të ligjit nr. 84/2016.

23. Nga krahasimi i deklaratave periodike vjetore me deklaratën “Vetting”, referuar nenit 32/5, të ligjit nr. 84/2016 (në funksion të nenit D të aneksit të Kushtetutës, për kontrollin e saktësisë dhe mjaftueshmërisë së deklarimit dhe burimi i ligjshëm i pasurive), rezulton si vijon:

24. Për pasurinë “Apartament banimi me sipërfaqe 76 m²”, ndodhur në Durrës

24.1 Në deklaratën “Vetting”, subjekti ka deklaruar: Shtëpi banimi regjistruar në pronësi të Elvin Gokaj dhe ***.**, me datë 17.6.2014: Zyra e regjistrimit Durrës, Z. K. ***, nr. pasurie ***, vol. ***, f. **, lloji i pasurisë apartament, sip. totale 76 m². *Burimi i krijimit:* Kursime nga paga e tij dhe e bashkëshortes ndër vite. *Vlera:* 30.000 euro. Pjesa takuese 100%.

24.2 Në DV 2009, subjekti i rivlerësimin ka deklaruar: Kontratë sipërmarrje apartament banimi, sip. 84.5 m² lidhur me “***” sh.p.k., datë 30.4.2009. *Burimi i krijimit:* (i) mbyllje depozite në *** Bank, në datë 24.4.2009; shuma 1.048.600,66 lekë dhe (ii) pasuri në vlerë leku, të ruajtur në banesë, në vlerën 1.377.615 lekë, të bashkëshortes, deklaruar në vitin 2009. *Vlera:* 30.000 euro. *Pjesa takuese:* 100%.

24.3 Në faqen 5 të DV -2009, në rubrikën “Detyrimet financiare ndaj personave juridikë dhe fizikë”, subjekti i rivlerësimin ka përshkruar detyrimin financiar sipas kontratës së sipërmarrjes me objekt: blerjen e apartamentit me sipërfaqe⁶ 84.5 m². Gjendja e detyrimit e

⁶ Lidhur me mospërputhjen e sipërfaqes së apartamentit të parashikuar në kontratën e sipërmarrjes (84.5 m²), deklaruar në DV-2009 dhe atë të parashikuar në kontratën e shitjes (76 m²), deklaruar në deklaratën “Vetting”, Komisioni i ka kaluar subjektit të rivlerësimin barrën e provës, i cili, në përgjigje të saj, ka deklaruar se: “...Në lidhje me gjetjen tuaj si mospërputhje të sipërfaqes, sqaroj se vetëm 8 m² më pak në sipërfaqen e banimit konsiderohen diferencë e papërfillshme...;

mbetur pa shlyer deri në 31.12.2009 është 10.000 euro. Ky detyrim është deklaruar nga subjekti i rivlerësimit në Deklaratat e interesave private periodike për vitet 2009-2013.

24.4 Në DV-2014, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar: Shlyerje e kështit të fundit ndaj shoqërisë “****” sh.p.k., me mandat arkëtimi datë 30.5.2014 dhe Kontratën noteriale: Shitje Apartamenti nr.***,⁷ datë 30.5.2014 (shlyerje e borxhit me akt noterial nr.***, ky borxh është marrë për efekt të bankës, pasi afati për tërheqjen e depozitës ishte më datë 10.12.2014) dhe shlyerja është bërë më datë 30.5.2014, sipas marrëveshjes për dhënien e certifikatës së pronësisë me shoqërinë “****”. Vlera: 10.000 euro. Mbyllje depozite nr. *** (pjesa tjetër është lënë për shpenzime të tjera familjare).

24.5 Në dosjen e Komisionit është administruar si provë, ndër të tjera, dhe shkresa nr. *** prot., datë ***.6.2018, e ZVRPP-së Durrës. Përmes kësaj shkrese i është përcjellë Komisionit praktika e pasurive të regjistruara në emër të subjektit të rivlerësimit, z. Elvin Gokaj, sipas së cilës, në pronësi të subjektit të rivlerësimit dhe bashkëshortes së tij, znj. ***.***, rezulton e regjistruar pasuria nr.***, Z. K. ***, Vol. ***, f. ***, lloji “Apartament me sipërfaqe 76 m²” (Durrës).

24.6 Nga aktet e administruara në dosje rezulton se origjina e kësaj pasurie rrjedh nga Kontratë sipërmarrje⁸ e datës 30.4.2009, lidhur midis shoqërisë “****” sh.p.k., në cilësinë e *sipërmarrësit*, dhe subjektit të rivlerësimit, z. Elvin Gokaj, në cilësinë e *porositësit*, dhe kontrata e shitjes së apartamentit me nr.***, datë 30.5.2014, lidhur midis shoqërisë ndërtimore “****” sh.p.k., në cilësinë e *shitësit*, dhe subjektit të rivlerësimit, z. Elvin Gokaj, dhe bashkëshortes së tij, znj. ***.***, në cilësinë e *blerësit*. Vlera e pasurisë është 30.000 euro.

24.7 Bazuar në kontratat e sipërcituara,⁹ si dhe në dy mandatarkëtime të administruara në dosjen e ILDKPKI-së, që lidhen me pagesat e kryera për apartamentin me sip. 76 m,² ndodhur në Durrës, rezulton se ky apartament është shlyer me dy këste. Kësti i parë, me vlerë 20.000 euro, është shlyer në datën 30.4.2009 dhe kësti i dytë, me vlerë 10.000 euro, është shlyer në datën 30.5.2014. Në vijim është analizuar mundësia financiare e subjektit të rivlerësimit dhe e bashkëshortes së tij për të mbuluar me të ardhura të ligjshme pagesën e këtyre dy kësteve.

24.8 Lidhur me pagesën e kështit të parë në vlerën 20.000 euro. Në kontratën e sipërmarrjes, lidhur në datën 30.4.2009, specifikohet se kësti i parë, në shumën 20.000 euro, likuidohet me lidhjen e kësaj kontrate. Gjithashtu, kjo pagesë vërtetohet me mandatarkëtimin që mban datën 30.4.2009¹⁰.

24.9 Në DV- 2009, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar si burim për pagesën e kështit të parë: (i) mbyllje depozite në *** Bank, në datën 24.4.2009, vlera 1.048.600,66 lekë; dhe (ii) pasuri në vlerë leku, të ruajtur në banesë, në vlerën 1.377.615 lekë, të bashkëshortes, deklaruar në vitin 2009.

gjykoj se kjo sipërfaqe është e drejtë të jetë e pagueshme për shkak të përlllogaritjes së ambienteve të përbashkëta mes banorëve”.

⁷ Nga aktet në dosje të Komisionit konstatojmë se kontrata për shitjen e apartamentit mban nr.*** rep. dhe nr. *** kol., datë 30.5.2014.

⁸ Kontratë e panoterizuar.

⁹ Kontratë sipërmarrje e datës 30.4.2009 dhe kontratë e shitjes së apartamentit me nr.***, datë 30.5.2014.

¹⁰ Mandati i administruar në dosjen e ILDKPKI-së, pa numër, pa vulën e shoqërisë dhe pa firmën e subjektit të rivlerësimit.

- (i) Lidhur me mbylljen e depozitës në *** Bank, datë 24.4.2009, në shumën 1.048.600,66 lekë. Nga verifikimi i kësaj llogarie bankare¹¹ rezulton se, në datën 1.4.2009, është maturuar depozita në shumën 1.048.600 lekë, nga të cilat janë tërhequr *cash* 500.000 lekë në datën 24.4.2009, ndërsa shuma 547.400 lekë është transferuar në datën 24.4.2009 nga llogaria e depozitës, në llogarinë e pagës së subjektit në *** Bank. Nga shuma 547.400 lekë që u transferua në llogarinë e pagës, nga momenti i transferimit deri në datën 30.4.2009, datë kur është bërë pagesa e këstit të parë të apartamentit, janë tërhequr vetëm 120.000 lekë.
- (ii) Burimi tjetër i deklaruar nga subjekti i rivlerësimit në *DV-2009* është: pasuri në vlerë leku, e ruajtur në banesë, në vlerën 1.377.615 lekë. Nga aktet në dosje të Komisionit rezulton se, në *DV-2008* bashkëshortja e subjektit ka deklaruar: pasuri në vlerë leku, e ruajtur në banesë, në shumën 1.377.615 lekë, me burim nga mbyllja e dy depozitave bankare¹² dhe nga pagat e dy bashkëshortëve. Nga verifikimi i llogarive bankare¹³ të bashkëshortes së subjektit në *** Bank rezulton se: në periudhën nëntor - dhjetor të vitit 2008 janë maturuar dy depozita në emër të bashkëshortes së subjektit të rivlerësimit, përkatësisht në shumat 523.012,88 lekë dhe 204.331,83 lekë. Këto shuma janë tërhequr *cash* nga llogaritë bankare në dhjetor të vitit 2008.

24.10 Bazuar në deklarimin e subjektit të rivlerësimit në *DV-2009* është analizuar mundësia e subjektit të rivlerësimit dhe e bashkëshortes së tij për të mbuluar me burime të ligjshme pagesën e këstit të parë të apartamentit me sip. 76 m², në Durrës, kryer në datën 30.4.2009, në shumën 20.000 euro.

Tabela nr. 1 - Analizë financiare për periudhën 1.1.2009 - 30.4.2009

(1) Total likuiditete në datën 1.1.2009	2,422,223
Likuiditete në bankë në datën 1.1.2009	1,044,608
Likuiditete <i>cash</i> në datën 1.1.2009	1,377,615
(2) Të ardhurat 1.1.2009 - 30.4.2009	530,654
Të ardhurat nga pagat SR	375,512
Të ardhurat nga pagat bashkëshortja	155,142
(3) Total shpenzime	430,307
Shpenzime jetese bazuar në deklaratimet e subjektit në pyetësin nr. 3	418,510
Shpenzime udhëtimi ¹⁴	11,797
(4) Total likuiditete në datën 30.4.2009	739,708
Likuiditete në bankë në datë 30.4.2009	739,708
(5) Paguar kësti i parë i apartamentit (20.000 euro * 131.08)	2,621,600
Diferenca (1+2-3-4-5)	- 838,738

24.11 Nga analiza financiare si më sipër, konstatohet se subjekti dhe bashkëshortja e tij nuk kanë pasur të ardhura të ligjshme të mjaftueshme për të likuiduar këstin e parë të apartamentit në vlerën prej 20.000 euro, me një diferencë negative -838.738 lekë.

¹¹ Referuar informacionit të dërguar nga *** Bank, me shkresë nr. ***, datë 2.2.2018.

¹² Në faqen 10 të *DV-2008*, bashkëshortja e subjektit të rivlerësimit ka deklaruar mbyllje të dy depozitave në *** Bank më datë 27.11.2008, në vlerën 523.012 lekë dhe në datën 24.12.2008, në vlerën 205.750 lekë.

¹³ Referuar informacionit të dërguar nga *** Bank me shkresë nr.***, datë ***.2.2018.

¹⁴ Referuar të dhënave të sistemit Tims.

24.12 Vlen të theksojmë se, në analizën e mësipërme financiare, nuk janë përfshirë shpenzime të mundshme qiraje për familjen e subjektit të rivlerësimit për periudhën janar - prill 2009. Bazuar në deklaratimet e subjektit të rivlerësimit gjatë hetimit administrativ rezultojnë se familja e tij në këtë periudhë ka jetuar në Durrës, por subjekti nuk ka deklaruar shpenzime qiraje. Nëse në analizën e mësipërme financiare do të përfshiheshin edhe shpenzime për qira apartamenti, diferenca negative do të thellohej.

24.13 Subjektit i është kaluar barra e provës nga ana e Komisionit¹⁵, mbi diferencën negative të konstatuar për pagesën e kështit të parë, të paguar në datën 30.4.2009. Në parashtrimet e datës 7.6.2019, subjekti, për të provuar të kundërtën e konstatimeve të Komisionit, ka paraqitur një raport ekonomik¹⁶ për periudhën 1.1.2008 - 30.4.2009, me qëllim argumentimin se ka pasur aftësi financiare për pagimin e kështit të parë për blerjen e apartamentit.

24.14 Komisioneri Publik konstaton se subjekti i rivlerësimit, pas kalimit të barrës së provës, nuk arriti të provojë të kundërtën lidhur me diferencën negative të konstatuar për pagesën e kështit të parë të apartamentit, pasi: (i) Periudha e analizuar në raportin ekonomik të depozituar nga subjekti i rivlerësimit është: 1.1.2008 - 30.4.2009, dhe nuk korrespondon me periudhën e analizuar si më sipër 1.1.2009 - 30.4.2009. (ii) Nisur nga fakti se subjekti i rivlerësimit ka deklaruar kursimet *cash* që ka pasur gjendje në datën 31.12.2008, analizimi i likuiditeteve duke filluar nga 1.1.2008 - 30.4.2009, çon në një rezultat financiar jo të saktë. (iii) Sa i përket shpenzimeve të jetesës për këtë periudhë theksojmë se këto shpenzime janë llogaritur bazuar në deklaratimet e subjektit të rivlerësimit në pyetësorin nr. 3.

24.15 **Sa më sipër analizuar, Komisioneri Publik vlerëson se subjekti i rivlerësimit: (i) nuk ka deklaruar saktë burimin për pagesën e kështit të parë të këtij apartamenti, pasi depozita në shumën 1.048.000 lekë, që ai deklaroi si një nga burimet që kanë shërbyer për këtë pagesë, nga aktet në dosje rezultojnë se nuk është tërhequr e gjitha përpara datës 30.4.2009,¹⁷ kur është kryer pagesa e kështit të parë. (ii) Subjekti i rivlerësimit dhe bashkëshortja e tij nuk mbulojnë me të ardhura të ligjshme nga burime të ligjshme pagesën e kështit të parë të këtij apartamenti me një diferencë negative prej të paktën - 838.738 lekë.**

24.16 Lidhur me pagesën e kështit të dytë në vlerën 10.000 euro. Në kontratën e shitblerjes së këtij apartamenti, lidhur në datën 30.5.2014, ndërmjet Elvin Gokaj dhe ***.***, në cilësinë e *blerësve* dhe shoqërisë ndërtimore “****” sh.p.k., në cilësinë e *shitësit*, specifikohet se pagesa është likuiduar mes palëve jashtë zyrës së noterisë, vërtetuar me mandatarkëtim që mban datën 30.5.2014.

24.17 Sa i përket burimit që ka shërbyer për shlyerjen e këtij kështi, në deklaratën “*Vetting*”, subjekti ka deklaruar: kursime nga paga e tij dhe e bashkëshortes ndër vite, ndërsa në DV-2014 lidhur me burimin e këtij kështi, subjekti ka deklaruar: “*10.000 euro nga mbyllje e depozitës me nr. *** (shlyer borxhi me akt noterial ***, ky borxh është marrë për efekt të bankës, pasi afati për tërheqjen e depozitës ishte më datë 10.12.2014 dhe shlyerja është bërë në datën 30.5.2014)...*”, për të cilën Komisioni ka konstatuar se nuk është deklaruar nga subjekti si

¹⁵ Lidhur me diferencën negative të konstatuar nga Komisioni në vlerën 826.717 lekë.

¹⁶ Raport ekonomik, datë ***.5.2019, përpiluar nga Kontabël i Miratuar, znj.***.***.

¹⁷ Shuma 547.400 lekë është kaluar në datën 24.4.2009 nga llogaria e depozitës në llogarinë e pagës së subjektit në *** Bank. Nga kjo shumë e transferuar në llogarinë e pagës deri në datën 30.4.2009, datë kur është bërë pagesa e kështit të apartamentit, janë tërhequr 120.000 lekë.

burim për krijimin e kësaj pasurie, duke i kaluar subjektit barrën e provës, bazuar në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016.

24.18 Në përgjigje të barrës së provës, subjekti i rivlerësimit ka shpjeguar se si burim për shlyerjen e këstit të dytë të apartamentit nuk është huaja e marrë nga z. ***.*** (***.***), por pagat dhe depozita bankare, e cila maturohej disa muaj më vonë sesa afati për të shlyer këstin e fundit ndaj firmës “***” sh.p.k. Pra, arsyeja e marrjes së huas justifikohet nga pamundësia për të prekur depozitën para afatit të maturimit, sipas kushteve të bankës, e cila është realisht në vetvete burim financiar i shlyerjes së këstit të dytë, e gjeneruar nga të ardhurat nga pagat e subjektit dhe të bashkëshortes.

24.19 Komisioni, në lidhje me mosdeklarimin e huas si burim në deklaratën “Vetting” për pagesën e këstit të dytë, ka konkluduar se subjekti i rivlerësimit ka qenë bindës në shpjegimet e tij, duke argumentuar se burimi real kanë qenë të ardhurat e tij nga depozita në *** Bank.

24.20 Në vlerësimin e Komisionerit Publik, ndryshe nga sa ka konstatuar Komisioni, subjekti i rivlerësimit nuk ka deklaruar saktë në deklaratën “Vetting” burimin për pagesën e këstit të dytë për blerjen e kësaj pasurie. Subjekti i rivlerësimit, në momentin e plotësimit të deklaratës “Vetting”, ka pasur detyrimin të plotësonte të dhënat për çdo pasuri në pronësi dhe të shpjegonte dhe të provonte mjaftueshëm lidhur me burimin e krijimit të saj, në përputhje me nenin 30 të ligjit nr. 84/2016.

24.21 *Në përfundim*, lidhur me pasurinë apartament me sip. 76 m², ndodhur në Durrës, Komisioni ka konkluduar se: *“...Duke arsyetuar mbi bazën e parimit të proporcionalitetit, duke vënë në balancë vlerën e kësaj pamjaftueshmërie, në raport me provat e tjera të administruara nga Komisioni, nëpërmjet hetimit të tij, Komisioni vlerëson se subjekti ka arritur të argumentojë burimin e ligjshëm të pasurive dhe të ardhurave të veta, si detyrimi kryesor kushtetues i tij. Mungesa e të ardhurave për pagesën e këstit të parë nuk mund të shërbejë si shkak për masë disiplinore, duke qenë se nuk përmbushen kriteret e parashikuara në pikën 1 dhe 3 të nenit 61”*.

24.22 Komisioneri Publik, ndryshe nga përfundimi që ka arritur Komisioni në arsyetimin e vendimit të tij, vlerëson se referenca e Komisionit të parimi i “proporcionalitetit” është bazuar në një interpretim të gabuar të normativës kushtetuese dhe ligjore, dhe se në referencë të nenit D, pikat 1 dhe 5 të aneksit të Kushtetutës, dhe nenit 61, pika 3, të ligjit nr. 84/2016, subjekti i rivlerësimit ndodhet në kushtet e deklaramit të pamjaftueshëm lidhur me këtë pasuri.

25. Llogari bankare në emër të subjektit të rivlerësimit dhe të bashkëshortes së tij pranë Bankës *, si dhe llogaritë dyemërore, të padeklaruara nga subjekti i rivlerësimit**

25.1 Për efekt të analizës financiare dhe vlerësimit mbi burimet e ligjshme të krijimit të depozitave bankare, në vijim janë trajtuar të gjithë depozitat bankare, në emër të subjektit dhe të bashkëshortes së tij, si dhe depozitat bankare dyemërore në emër të ***.*** dhe ***.*** (nëna e subjektit të rivlerësimit), si dhe në emër të ***.*** dhe ***.*** (nëna e saj).

25.2 *Në deklaratën “Vetting”, subjekti i rivlerësimit dhe bashkëshortja kanë deklaruar tri depozita bankare, si më poshtë:*

- (i) *“Depozitë me afat pranë Bankës ***, në emër të subjektit të rivlerësimit me nr. llogarie: “***”. Vlera: 4.100.000 lekë. Burimi i krijimit: Kursime nga paga e subjektit dhe e bashkëshortes ndër vite. Pjesa takuese: 100%”.*
- (ii) *“Depozitë me afat pranë Bankës ***, në emër të bashkëshortes së subjektit, në vlerën 10,000 euro, me nr. llogarie: “***”. Burimi i krijimit: Kursime nga paga e bashkëshortes ndër vite, bashkim me depozitën në vlerë 4.000 euro, nr. “***”, datë 15.12.2015, në Bankën ***, shitja e automjetit i deklaruar me numër kontrate nr. *** rep., nr. *** kol., datë 16.5.2015, në vlerën 2,000 euro. Pjesa takuese:100%”.*
- (iii) *“Depozitë me afat pranë Bankës ***, në emër të bashkëshortes së subjektit, në vlerën 10,000 euro, me nr. llogarie “***” çelur në datën 26.8.2016. Burimi i krijimit: Kursime nga paga e bashkëshortes ndër vite, mbyllje në datën 26.7.2016, të depozitës në lekë, e deklaruar me nr. “***”, mësimdhënia në Hungari, në Universitetin e West Hungary. Pjesa takuese: 100%”.*

25.3 Lidhur me depozitën (ii), në emër të bashkëshortes së subjektit, në vlerën 10,000 euro, me nr. llogarie: “***”, gjatë hetimit administrativ, Komisionit i ka rezultuar se:

*“Bazuar në të dhënat e *** Bank rezulton që llogaria nr. *** në euro, në emër të bashkëshortes së subjektit të rivlerësimit është hapur më datë 29.5.2012, duke derdhur cash në depozitë shumën 5 000 euro. Në datë 29.5.2013, kjo shumë rezulton e transferuar në llogarinë dyemërore nr. *** në euro, në emër të ***,*** ose ***,***”.*

*“Në datën 30.5.2013, llogaria nr. *** në euro, në emër të bashkëshortes së subjektit në ***, është kredituar me shumën 6000 euro, e cila e ka burimin nga urdhërshirimi i brendshëm me urdhërues ***,*** ose ***,***, me përshkrim “kalim në depozitë 12-mujore nga llogaria nr. “***”.*

*“Më datë 15.12.2015, nëpërmjet një derdhje cash në shumën 4.000 euro, është hapur llogaria nr. *** në emër të znj.***,***. Në datën 31.5.2016, në llogarinë nr. ***, në euro, është transferuar shuma prej 4004.65 euro, me përshkrimin: “kalim në dep. 12 M nga llogaria nr. *** e znj.***,***”. Gjendja në datën 31.12.2016 e kësaj llogarie është 10.001.48 euro”.*

25.3.1 Sa më sipër, Komisioni ka konstatuar se, ndryshe nga sa ka deklaruar subjekti në përgjigje të pyetësorit të datës 10.12.2018, bashkëshortja e tij ka kryer transferta bankare nga llogaria e saj personale në llogarinë e përbashkët me nënën e subjektit dhe anasjelltas, duke krijuar paqartësi në burimin e të ardhurave të deklaruara nga subjekti.

25.3.2 Sa më sipër, Komisioni i ka kaluar subjektit barrën e provës për të provuar të kundërtën, pasi: (i) deklaratimet e subjektit nuk përputhen me të dhënat e administruara nga hetimi në lidhje me burimin e krijimit të kësaj depozite; (ii) subjekti i rivlerësimit nuk ka deklaruar transfertat bankare të kryera nga bashkëshortja te nëna e tij dhe anasjelltas.

25.3.3 Pas kalimit të barrës së provës për këto rezultate të hetimit, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar: (i) ...Burimi i kësaj shume është depozita e hapur më datë 29.5.2012, me vlerë 5.000 euro, e cila në momentin e maturimit kapitali së bashku me interesat kalojnë automatikisht në

llogari rrjedhëse ndihmëse...bëhet një derdhje cash prej 538 euro, si dhe kalime automatikisht të interesave nga llogari të tjera dyemërore dhe arrin shumën 6.000 euro.

(ii) Lidhur me transfertat bankare të kryera nga bashkëshortja te nëna e tij dhe anasjelltas, subjekti ka deklaruar: “...bashkëshortja ime ka qenë person i besuar nga prindërit e mi dhe e njohur nga banka në lidhje me veprimet bankare; por në çdo rast kapitali në llogaritë dyemërore, ku emër i parë është ***.***, është pasuri monetare e prindërve krijuar nga kursimet e veta; depozitat dyemërore ku ***.*** është person i besuar nga titullari i kapitalit, në momentin e çeljes së tyre, janë të lidhura automatikisht me numër llogarie rrjedhëse ndihmëse; ...llogaria rrjedhëse ndihmëse shërben për të mbajtur kapitalin bashkë me interesat, çka ndodh automatikisht nga banka në ditën e maturimit të depozitës; ...***.*** ka një llogari rrjedhëse ndihmëse dhe, sipas sugjerimeve të punonjësve të bankës, për lehtësim procedurash bankare, nuk është konsideruar e nevojshme të hapen të tjera...”.

25.3.4 Në përfundim, Komisioni ka vlerësuar se subjekti ka qenë i saktë në deklarinimin e tij. Të dhënat e referuara prej tij konfirmohen edhe nga dokumentacioni shkresor i institucioneve përkatëse. Nga hetimi administrativ nuk rezultojnë të dhëna të paqarta apo dyshime në lidhje me këtë pasuri.

25.3.5 Komisioneri Publik, bazuar në aktet në dosje, konstaton se në datën 29.5.2012 është derdhur *cash* në depozitë, në llogarinë personale të znj. ***.***, me nr. ***, shuma 5.000 euro. Në datën 29.5.2013, në momentin e maturimit të depozitës, e gjithë shuma prej 5.148,25¹⁸ euro ka kaluar në llogarinë rrjedhëse dyemërore me nr. ***, në emër të bashkëshortes së subjektit dhe znj.***.*** (nëna e subjektit). Pas kalimit në llogarinë dyemërore, shumës 5.148,25 euro i është shtuar një depozitim *cash*¹⁹, si dhe **interesat të gjeneruara nga një depozitë tjetër dyemërore me nr. ***, në emër të bashkëshortes së subjektit dhe znj.***.***²⁰.**

25.3.6 Shuma totale prej 6.000,89 euro është transferuar në një depozitë tjetër personale, në emër të bashkëshortes së subjektit, me nr. ***, duke përfutur edhe interesat e gjeneruara nga depozita dyemërore. **Pra, ndryshe nga çfarë ka deklaruar bashkëshortja e subjektit²¹, se nuk ka përfutur asnjë pjesë nga kapitali apo interesi që lidhen me depozitat dyemërore, nga sa më sipër, vërtetohet se ajo ka përfutur interesa nga depozitat dyemërore.**

25.3.7 **Sa më sipër, Komisioneri Publik**, bazuar në aktet e administruara në dosjen e Komisionit, konstaton se: (i) Bashkëshortja e subjektit ka përfutur nga interesat e depozitave dyemërore;²² (ii) rezultojnë kalime fondesh nga llogaria personale e bashkëshortes së subjektit në llogarinë dyemërore në emër të ***.*** dhe ***.*** dhe anasjelltas; (iii) ndryshe nga sa është deklaruar nga subjekti, bashkëshortja e tij në këto llogari bankare dyemërore është në cilësinë e depozituesit/titullare e llogarive bankare dhe jo “person i besuar/autorizuar”, siç pretendon subjekti i rivlerësimit.

¹⁸ Shuma e depozitës 5.000 euro është maturuar dhe së bashku me interesat ka arritur në shumën 5.148,25 euro.

¹⁹ Në llogarinë dyemërore është derdhur *cash* shuma 538 euro, me përshkrim “derdhje në llogari”.

²⁰ Nga depozita dyemërore, në euro, në emër të ***.*** & ***.***, në shumën 10.005 euro, janë gjeneruar interesa në momentin e maturimit në shumën 314,64 euro.

²¹ Në rubrikën të dhëna konfidenciale në DV-2015.

²² Referohuni transaksionit të kryer nga bashkëshortja e subjektit të rivlerësimit, të datës 29 – 30.5.2013, në llogarinë ***, në *** Bank.

26. Llogaritë bankare të përbashkëta të padeklaruara

26.1 Referuar akteve në dosjen e Komisionit, rezulton se në periudhën 2010 - 2016, bashkëshortja e subjektit të rivlerësimit, znj. ***.***, ka pasur disa llogari të përbashkëta dyemërore në *** Bank, me znj. ***.*** (nëna e subjektit të rivlerësimit) dhe me znj. ***.*** (nëna e saj). Siç konfirmohet edhe nga informacioni i dërguar nga *** Bank, në këto llogari bankare janë depozituar vlera të konsiderueshme në monedhën lekë dhe euro.

26.2 Nga verifikimi i deklaratave periodike vjetore për vitet 2010 – 2016, të dorëzuara nga subjekti i rivlerësimit pranë ILDKPKI-së, rezulton që depozitat e mësipërme **nuk janë deklaruar**.

26.3 Në DV-2015, bashkëshortja e subjektit të rivlerësimit në rubrikën: “Të dhëna konfidenciale”, ka deklaruar: *“Lidhur me të gjitha depozitat që figurojnë në emrin tim si person i autorizuar në Bankën *** nga titullari i kapitalit ***.*** (vjehrra), deklaroj se nuk kam asnjë pjesë të kapitalit apo interesit, por në çastin më të parë të ardhjes nga Italia personi do të bëjë shkëputjen e emrit tim”*.

26.4 Në pyetësin nr. 3, subjekti është pyetur nga Komisioni lidhur me përkatësinë e këtyre vlerave monetare dhe arsyen përse nuk janë deklaruar këto depozita në deklarata periodike vjetore. Në përgjigje të pyetësit nr. 3, datë 10.12.2018, lidhur me sa më sipër, subjekti i rivlerësimit, ndër të tjera, ka deklaruar: *“...Theksoj se çdo llogari në çdo lloj banke që operon në Shqipëri, ku titullar i kontratës me bankën është nëna ime, ***.***, janë kursimet e prindërve të mi nga të ardhurat ndër vite që kanë përfutur në Itali. Unë kam pasur dijeni për të ardhurat dhe pasurinë e prindërve, por nuk kam pasur asnjë motiv për të deklaruar këto shuma, pasi kapitali nuk është aset i familjes sime bërthamë, subjekt i deklarimit periodik të pasurisë. Gjithashtu, bashkëshortja ime, edhe pse person i besuar për të kryer veprimet bankare, nuk ka pasur asnjë rast të derdhjes apo tërheqjes së kapitalit pa praninë e nënës time, ***.***, dhe për këtë arsye nuk kam qenë i obliguar për të deklaruar pasurinë e prindërve të mi”. Për rastin në fjalë jam vënë në dijeni për herë të parë në takimin e vetëm sqarues gjatë gjithë periudhës së punës time pranë ILDKPKI-së, në datën 17.2.2016, vit në të cilin këto veprime janë deklaruar nga bashkëshortja ime te rubrika “Konfidenciale”²³ e formularit të deklarimit...”. Të njëjtin qëndrim, subjekti i rivlerësimit ka mbajtur edhe për llogaritë dyemërore në emër të bashkëshortes së subjektit dhe nënës së saj, znj. ***.***.*

26.5 Në përfundim të hetimit administrativ, Komisionit, ndër të tjera, i ka rezultuar se:

- (i) *Subjekti i rivlerësimit duket se nuk ka deklaruar në lidhje me llogaritë dyemërore, pasi, siç rezulton, ka transferta bankare ndërmjet llogarive të prindërve të tij dhe nënës së bashkëshortes së tij.*
- (ii) *Është e paqartë se cila ka qenë arsyeja e transferimit të shumës 1,010,010.72 lekë nga llogaria e nënës së bashkëshortes së tij te llogaria e prindërve të tij, si dhe kush e ka tërhequr këtë shumë në datën 6.6.2016, për të cilat, bazuar në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016, i kaloi subjektit të rivlerësimit barrën e provës, për të provuar të kundërtën e rezultateve të hetimit.*

26.6 Në përgjigje të barrës së provës, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar:

²³ Deklarim i bërë nga bashkëshortja e subjektit të rivlerësimit, në DV-2015.

- (i) “...llogaritë dyemërore të ***.*** me ***.*** dhe ***.*** me ***.*** nuk i kam konsideruar objekt i deklarimit të pasurisë, pasi që kapitali i depozituar është në të gjitha rastet ose i ***.*** (ku person i besuar është ***.***) ose i ***.*** (ku person i besuar është ***.***... theksoj se nuk ka asnjë rast për transferta bankare të tilla nga llogaritë e depozitave dyemërore ***.*** (***.***) te llogaria depozitës dyemërore ***.*** (***.***) dhe anasjelltas...”.
- (ii) “...Burimi i kësaj depozite është kthimi i borxhit që ***.*** i kishte marrë më herët prindërve të mi, që në momentin e kthimit, me miratimin paraprak i sjell te bashkëshortja ime, ***.***, duke qenë se ishte **person i autorizuar** për të kryer veprimet me bankat. Shuma 1.010.010,72 lekë është derdhur nga ***.*** në llogarinë rrjedhëse dyemërore për të shmangur mbajtjen e parave në banesë, me qëllim që ***.***, me ardhjen më të parë në Shqipëri, të ketë mundësi të veprojë si ta gjykojë të arsyeshme me këtë shumë, veprim i kryer nga vetë ***.*** si titullare e depozitës me datë 14.8.2013... Lidhur me lëvizjet me urdhërshirime të brendshme të kryera në llogaritë rrjedhëse dyemërore nga ***.***, sqaroj se këto veprime janë kryer meqenëse ***.*** ka pasur akses si person i besuar për të kryer veprime bankare dhe nga ***.***, dhe nga ***.***...”.

26.7 Komisionit, në lidhje me depozitat e përbashkëta dyemërore, i ka rezultuar se: Nga analizimi i dokumentacionit të administruar dhe shpjegimeve të subjektit rezulton se ai ka qenë i saktë në deklaratën “Vetting”, pasi llogaritë dyemërore janë mbyllur gjatë vitit 2016, sikundër është deklaruar në deklaratën e interesave private të vitit 2015, rrjedhimisht subjekti i rivlerësimit nuk ka pasur detyrimin ligjor për të deklaruar këtë llogari. Nga hetimi administrativ ka rezultuar se mbajtësit e llogarive, prindërit e tij, si dhe nëna e bashkëshortes së tij, kanë vërtetuar me dokumentacion provues aftësinë financiare të tyre për të hapur këto depozita dhe, rrjedhimisht, nuk lindin dyshime që këto llogari të kenë si burim të ardhura të krijuara në mënyrë të paligjshme nga subjekti i rivlerësimit.

26.8 Komisioneri Publik, nga verifikimi i akteve në dosjen e Komisionit, konstaton se, në periudhën 2010 - 2016, bashkëshortja e subjektit të rivlerësimit, znj. ***.***, ka pasur llogari të përbashkëta dyemërore, të paraqitura në formë tabelare si më poshtë:

Tabela nr. 2

Llogari bankare dyemërore në emër të bashkëshortes së subjektit të rivlerësimit						
Përshkrimi	2010	2011	2012	2013	2014	2015
Depozitë 2EM, euro ***.*** & ***.***	5,400	5,618				
Depozitë 2EM lekë ***.*** & ***.***			1,000,004			
Depozitë 2EM, euro ***.*** & ***.***			10,005			
Depozitë 2EM, euro ***.*** & ***.***			10,005			
Depozitë 2EM, euro ***.*** & ***.***				10,232	15,599	15,599*
Depozitë 2EM, euro ***.*** & ***.***				10,005	10,004	15,160**
Depozitë 2EM lekë ***.*** & ***.***				1,010,010		
Depozitë 2EM, euro ***.*** & ***.***				5,000		

Depozitë 2EM lekë ***.*** & ***.***					1,010,010	
Depozitë 2EM lekë ***.*** & ***.***						1,001,900***

26.9 Bazuar në informacionin e dërguar nga *** Bank,²⁴ lidhur me krijimin e depozitave të mësipërme dyemërore, konstatohet se:

* Lidhur me depozitën dyemërore në emër të ***.*** dhe ***.***, e cila në datën 31.12.2015 rezulton në vlerën 15.599 euro, nga aktet në dosje konstatohet: Në datën 13.8.2010 është depozituar *cash* dhe është kaluar në depozitë me afat në emër të ***.*** dhe ***.*** shuma 5.400 euro, me përshkrimin: “Derdhje ***.***”. Në datën 5.1.2012 është depozituar *cash* në emër të ***.*** dhe ***.*** shuma 4.000 euro, me përshkrimin: “Cel dep ***.***”. Në gusht të vitit 2012, këto dy depozita janë bashkuar dhe kanë arritur vlerën totale 10.005,89 euro²⁵. Në gusht 2013 depozitohet *cash*²⁶ shuma 5.000 euro në emër të ***.*** dhe ***.*** dhe në qershor 2014, kjo shumë bashkohet me depozitën në vlerën 10.005.89 euro dhe arrin shumën totale 15.599,59 euro.

** Lidhur me depozitën dyemërore në emër të ***.*** dhe ***.***, e cila në datën 31.12.2015 rezulton në vlerën 15.160 euro, nga aktet në dosje konstatohet se: Në datën 5.1.2012 është depozituar *cash* dhe është kaluar në depozitë me afat në emër të ***.*** dhe ***.*** shuma 10.003 euro me përshkrimin: “hapje dep 3m eur ***.***”. Në janar 2015 depozitohet *cash*²⁷ shuma 5.000 euro në emër të ***.*** dhe ***.*** dhe në qershor 2015 kjo shumë bashkohet me depozitën në vlerën 10.003 euro dhe arrin në shumën totale 15.160,99 euro.

*** Lidhur me depozitën dyemërore në emër të ***.*** dhe ***.***, e cila në datën 31.12.2015 ka arritur vlerën 1.001.900 lekë, nga aktet në dosje konstatohet se: Nga nxjerrja e llogarisë të *** Bank konstatohet se bashkëshortja e subjektit ka pasur një depozitë dyemërore pranë kësaj banke me mamanë e saj, znj.***.***, në vlerën 1.000.0004 lekë. Pas maturimit të kësaj depozite rezulton se janë tërhequr *cash* nga ***.***, në datën 22.6.2013, 990.000 lekë nga kjo depozitë. Vetëm dy ditë më pas, në datën 24.6.2013, në po këtë llogari dyemërore depozitohet *cash* shuma 1.000.000 lekë²⁸. Shuma e depozituar 1.000.000 lekë + tepicën e kësaj llogarie në vlerën 10.010.72 lekë, në total shuma 1.010.010,72 lekë transferohen në datë 14.08.2013 nga llogaria dyemërore në emër të ***.*** & ***.***, në llogarinë dyemërore: ***.*** & ***.***.

26.10 Sa më sipër analizuar, Komisioneri Publik konstaton: (i) Derdhje *cash* në llogaritë dyemërore të kryera nga vetë bashkëshortja e subjektit. (ii) Nga shuma 1.010.010,72 lekë, që është transferuar nga llogaria ***.*** & ***.*** në llogarinë dyemërore ***.*** & ***.*** përfshihet jo vetëm shuma prej 1.000.000 lekësh, që është depozituar nga bashkëshortja e subjektit dhe që pretendohet se është një hua kundrejt nënës së subjektit, por përfshihet edhe

²⁴ Shkresa nr. *** prot., datë ***.3.2018, e *** Bank.

²⁵ Në shumën 10.005,89 euro përfshihen edhe interesat e këtyre dy depozitave si dhe një depozitim *cash*, në shumën 145 euro.

²⁶ Nuk identifikohet depozituesi.

²⁷ Nuk identifikohet depozituesi.

²⁸ Në parashtrimet përfundimtare, datë 6.7.2019, subjekti ka deklaruar se kjo shumë është depozituar *cash* nga bashkëshortja e tij.

teprica e llogarisë në emër të ***.*** & ***.***. (iii) Janë përfituar interesa nga depozitat dyemërore, duke i kaluar në llogarinë personale të bashkëshortes.

26.11 Në aktet në dosje janë administruar gjithashtu edhe disa kontrata depozitash, të paraqitura nga subjekti i rivlerësimit, si më poshtë: *i*) “Kontrata e depozitës me afat 12 -muor”, e datës 13.8.2010, pranë Bankës ***, me “titullarë të llogarisë/depozitues” ***.*** ose ***.***, në vlerën 5.400 euro; *ii*) “Kontrata e depozitës me afat 7-muor”, e datës 5.1.2012, pranë Bankës ***, me “titullarë të llogarisë/depozitues” ***.*** ose ***.***, në vlerën 4.000 euro; *iii*) “Kontrata e depozitës me afat 6-muor”, e datës 14.8.2013, pranë Bankës ***, me “titullarë të llogarisë/depozitues” ***.*** ose ***.***, në vlerën 5.000 euro; *iv*) “Kontrata e depozitës me afat 3-muor “****”, e datës 17.1.2015, pranë Bankës ***, me “titullarë të llogarisë/depozitues” ***.*** ose ***.***, në vlerën 5.000 euro.

26.12 Komisioneri Publik, referuar kontratave të mësipërme, si dhe informacionit të depozituar nga Banka ***, me shkresën nr. ***, datë ***.3.2018, vlerëson se znj. ***.*** figuron bashkëtitullare në depozitat pranë Bankës *** dhe “*de jure*” edhe bashkëpronare e tyre, duke pasur detyrimin e deklarimit të këtyre depozitave në DV-në respektive, bazuar në ligjin nr. 9049/2003, “Mbi deklarimin dhe kontrollin e pasurive, detyrimeve financiare të personave të zgjedhur dhe nëpunësve të caktuar publikë”.

26.13 Në referencë të nenin 199, paragrafi i dytë i Kodit Civil, i cili parashikon se: “*Pjesët e bashkëpronarëve janë të barabarta, gjersa nuk vërtetohet e kundërta*”, pjesa takuese e znj. ***.*** në këto depozita është 50% e tyre dhe, për këtë arsye, bazuar në nenin D të aneksit të Kushtetutës, duhet të analizohej lidhur me burimin e ligjshëm të krijimit të tyre.

26.14 Komisioneri Publik konstaton se në analizën financiare të kryer nga Komisioni për periudhën 2010-2016 (periudhë kur janë krijuar këto depozita dyemërore) nuk është përfshirë në analizën financiare pjesa takuese e bashkëshortes së subjektit në këto depozita bankare. Po ashtu dhe shpenzimet e udhëtimit jashtë vendit për subjektin dhe familjarët e tij nuk janë llogaritur sipas metodologjisë të përdorur në jurisprudencën e Kolegjit, vendimi (JR) 11/2019.

26.15 Nga përfshirja në analizën financiare e pjesës takuese të bashkëshortes në depozitat dyemërore, si dhe nga llogaritja e shpenzimeve të udhëtimit sipas metodologjisë së sipërcituar, rezulton se subjekti i rivlerësimit dhe bashkëshortja e tij nuk mbulojnë me të ardhura të ligjshme shpenzimet dhe kursimet e krijuara për periudhën 2010-2016, me diferencë negative – 1.999.397 lekë.

27. Në përfundim, lidhur me kriterin e vlerësimit të pasurisë, Komisioneri Publik konstaton se subjekti i rivlerësimit, në referencë të nenit D, pikat 1 dhe 5 të aneksit të Kushtetutës, dhe nenit 61, pika 3, të ligjit nr. 84/2016, ndodhet në kushtet e deklarimit të pamjaftueshëm, pasi: (i) nuk ka deklaruar saktë burimin për pagesën e këstit të parë të apartamentit në Durrës; (ii) nuk mbulon me të ardhura nga burime të ligjshme pagesën e këstit të parë të apartamentit në Durrës, me një diferencë negative prej - 838.738 lekë; (iii) nuk ka deklaruar saktë në deklaratën “Vetting” burimin për pagesën e këstit të dytë për blerjen e apartamentit në Durrës; (iv) nuk ka deklaruar depozitat e përbashkëta dyemërore të bashkëshortes së tij, respektivisht me znj.*.*** dhe znj.***.***; (v) subjekti i rivlerësimit dhe bashkëshortja e tij nuk mbulojnë me të ardhura të ligjshme shpenzimet dhe kursimet e krijuara për periudhën 2010-2016 me një diferencë negative, në total në vlerën – 1.999.397 lekë. Bazuar në rezultatet e hetimit dhe analizën financiare**

rezulton se për periudhën e hetuar subjekti i rivlerësimit ka mungesë të ardhurash të ligjshme në total në shumën - 2.838.135 lekë.

28. Komisioneri Publik, në konsideratë të parashikimeve kushtetuese të nenit D të aneksit të Kushtetutës, në kushtet kur nga analiza financiare për periudhën e hetuar, subjekti dhe personat e lidhur rezultojnë me balancë negative totale në shumën - 2.838.135 lekë, vlerëson se subjekti i rivlerësimit nuk ka arritur një nivel të besueshëm për kriterin e pasurisë.

28.1 Kjo situatë vlerësohet se cenon besueshmërinë e subjektit në respektimin e ligjit dhe, për rrjedhojë, edhe besimin e publikut te sistemi i drejtësisë. Për më tepër, në kushtet kur edhe nga vlerësimi i kriterit të aftësive profesionale, Komisioni ka konstatuar²⁹ dukshëm se subjekti i rivlerësimit në rastet e trajtuara në vendim ka shfaqur njohuri, aftësi dhe gjykim të cekët në punën profesionale të tij, si dhe ka konstatuar një mënyrë pune që nuk pajtohet me pozicionin e tij si drejtues i Prokurorisë, duke arritur në konkluzionin se subjekti ka pasur detyrimin ligjor të thellohej në arsyetimin e vendimeve, të kontrollonte lidhjen logjike të argumenteve me kërkimet e prokurorëve përpara gjykatës, si detyrim ligjor i përcaktuar nga ligji procedural penal dhe aktet nënligjore të dala në zbatim të tij. Marrë në konsideratë se një numër i konsideruar i rasteve me mangësi të theksuara në gjykim janë konstatuar si rezultat i denoncimeve të ardhura nga publiku, thëllon bindjen për cenimin e besimit të publikut te sistemi i drejtësisë.

28.2 Gjithashtu, Komisioni, lidhur me kriterin e kontrollit të figurës, referuar nenit DH, të aneksit të Kushtetutës, kreut V të ligjit nr. 84/2016, ka konkluduar *“Përshtatshmërinë për vazhdimin e detyrës”* të subjektit të rivlerësimit, në mungesë të informacionit nga ana e SHISH³⁰.

28.3 Komisioneri Publik vlerëson se sa më sipër do të trajtohen nga Kolegji i Posaçëm i Apelit, nisur dhe nga fakti se ata kanë të drejtë të çmojnë sipas bindjes së tyre të brendshme çdo indicie në tërësi lidhur me rrethanat e çështjes.

28.4 Sa më sipër, **Komisioneri Publik**, në të tilla kushte, ku subjekti rezulton me mangësi dhe mospërbushje të kërkesave të parashikuara në aneksin e Kushtetutës dhe legjislacionin e posaçëm, për kriteret e procesit të rivlerësimit, çmon se rezultatet e hetimit administrativ duhen analizuar në vlerësim tërësor të çështjes, në kuptim të nenit 4, pika 2, dhe në kuptim të nenit 61/5 të ligjit nr. 84/2016.

III. Kërkimi i ankimit

29. Nisur nga parashikimi i nenit 179/b/5 të Kushtetutës, aneksit të Kushtetutës, konsiderojmë se, ndryshe nga sa ka disponuar Komisioni i Pavarur i Kualifikimit, referuar gjendjes së fakteve dhe provave në rastin konkret, Komisioneri Publik ndan gjykim të kundërt, pasi vlerëson se subjekti i rivlerësimit nuk arrin nivel të besueshëm të vlerësimit të pasurisë;

30. Duke ritheksuar se Komisioneri Publik ka detyrimin që të ushtrojë kontroll mbi vendimet e dhëna nga Komisioni, me qëllim që të garantojë mbrojtjen e interesit publik në procesin e rivlerësimit, duke vlerësuar në qoftë se vendimmarrja e Komisionit është marrë në përputhje

²⁹ Faqe 59 e vendimit të Komisionit.

³⁰ Shkresë nr.*** prot., datë ***.11.2017, e DSIK-së (Deklasifikuar plotësisht me vendim të KDZH-së nr. ***, datë ***.2.2018).

me ligjin, në përfundim të një hetimi të plotë, mbështetur në faktet dhe provat e administruara për këtë qëllim;

31. Në të tilla kushte, ku subjekti rezulton me mangësi dhe mospërmbushje të kërkesave të parashikuara në aneksin e Kushtetutës dhe legjislacionin e posaçëm, për kriteret e procesit të rivlerësimit, Komisioneri Publik çmon se, nga vlerësimi tërësor i çështjes, në kuptim të nenit 4, pika 2, e ligjit nr. 84/2016, për subjektin konkret duhet të gjejë zbatim neni 61, pikat 3 dhe 5 të këtij ligji;

32. Bazuar në kërkesat e neneve Ç, D, DH dhe F, të aneksit të Kushtetutës, nenit 4 dhe nenit 61, pikat 3 dhe 5, të ligjit nr. 84/2016;

33. Kërkojmë që shkaqet e këtij ankimi të merren në shqyrtim nga ana e Kolegjit dhe, në zbatim të nenit 66, të ligjit nr. 84/2016, të vendosë:

- Ndryshimin e vendimit nr. 187, datë 24.7.2019, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, dhe shkarkimin nga detyra të subjektit të rivlerësimit, z. Elvin Gokaj.

KOMISIONERI PUBLIK

DARJEL SINA